

RAPORT VJETOR 2009

**Përgatitur për Mbledhjen e Kuvendit të STIKK
Janar, 2010**

RAPORT VJETOR 2009

1. PËRMBLEDHJE

Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës u themelua në vitin 2006 në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, mirëpo filloi punën e saj aktive duke ju falënderuar iniciativës së gjashtë kompanive themeluese si dhe përkrahjes së Qeverisë Norvegjeze përmes Crimson Capital dhe Shoqatës së TIK të Norvegjisë. Në periudhën tetor-nëntor 2008, nga ana e gjashtë kompanive themeluese të Shoqatës është aprovuar statuti i ri, është bërë regjistrimi në Ministrinë e Shërbimeve Publike si dhe është hapur kontoja bankare e Shoqatës. Të gjitha këto aktivitete janë zyrtarizuar në mbledhjen e parë të Kuvendit të STIKK, të mbajtur më 17 dhjetor 2008, ku edhe është bërë përzgjedhja e Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Bordit të STIKK. Gjatë muajve janar-shkurt është kryer edhe procedura e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të STIKK, e cila kontratë është nënshkruar më 23 shkurt 2009.

Më 30 prill, 2009, pas takimeve dhe diskutimeve në mes të STIKK dhe Crimson Capital, është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit me definimin e rolit dhe përgjegjësisë të secilës palë nënshkruese, si dhe me definimin e buxhetit prej **60,601.00€**, për mbështetjen e aktiviteteve të shoqatës, për periudhën 17 muajshe, që do të thotë, deri në korrik 2010.

Qëllimi parësor i STIKK-ut gjatë periudhës fillestare, në mes të dy Kuvendeve, ka qenë finalizimi i aktiviteteve të parapara për këtë fazë:

- funksionalizimi i zyrës dhe resurseve njerëzore,
- promovimi i shoqatës përmes pjesëmarrjes në panaire dhe konferenca lokale dhe ndërkombëtare,
- takime me anëtarë dhe anëtarë potencial,
- takime me shoqata rajonale,
- takime me donatorë dhe përfaqësues të Qeverisë si dhe
- përgatitja për fazën e dytë të operacionalizimit të aktiviteteve të shoqatës.

Përderisa shumica e obligimeve janë përmbushur në afat, zhvillimi i procedurave ligjore (draftimi i Statutit dhe akteve tjera nënligjore) ka pasë një vonesë. Më vonë gjatë vitit 2009, është themeluar grupi punues për draftimin e Statutit të ri, i cili ka përfunduar punën dhe ka përgatitur Statutin e ri të gatshëm për tu votuar në mbledhjen e Kuvendit, më 28 janar 2010.

2 QËLLIMET E STIKK

Vizioni i STIKK është të ketë një rol qëndror në stimulimin e rritjes dinamike të sektorit të TIK në Kosovë, duke rritur aftësinë konkurruese të sektorit dhe duke hapur mundësi të reja.

Misioni i STIKK është të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për TIK duke përmirësuar standardet, mundësitë e arsimimit si dhe përmes avokimit në Qeveri në emër të anëtarëve të saj, si dhe për të siguruar atraktivitetin e sektorit ndaj bizneseve dhe investimeve të reja.

Parimet kryesore të STIKK

Në përmbushjen e objektivave dhe implementimin e aktiviteteve, STIKK do të bazohet në parimet e paanshmërisë, kushteve të barabarta për të gjithë, konkurrueshmërisë dhe tregut të lirë, të aplikueshme në Kosovë dhe më gjerë.

3. AKTIVITETET

3.1. Aktivitetet e fazës fillestare

a) Regjistrimi i Shoqatës

Rezultati: Shoqata u regjistrua më 6 nëntor, 2008

b) Zhvillimi i Statutit dhe procedurave qeverisëse

Rezultati: Statuti fillestar u muar i gatshëm nga zyra për regjistrimin e OJQ-ve me rastin e regjistrimit të shoqatës. Draftimi i Statutit të ri, bazuar në projektin me Crimson Capital dhe IKT Norge është dashur të ndihmohet nga MASIT, por pas vonesës në nënshkrimin e marrëveshjes në mes të MASIT dhe Crimson Capital u vendos që të fillohet me një iniciativë tjetër. Pas konsultimeve, Bordi aprovoi themelimin e grupit punues të përbërë prej një anëtari të Bordit të STIKK, drejtoreshës ekzekutive të STIKK, menagjerit të programeve të Crimson Capital, specialistit të Teknologjisë Informative të programit KPEP të USAID-it si dhe konsulentit ligjor. Ky grup punues kishte për detyrë zhvillimin e një versioni të ri dhe më të përshtatshëm të Statutit dhe akteve tjera nënligjore. Versioni i parë përfundoi në nëntor 2009, dhe u vendos në forumin e anëtarëve në Uebfaqen e STIKK për komente dhe sygjerime. Aprovimi final i statutit do të bëhet në mbledhjen e Kuvendit, të paraparë për 28 Janar 2010.

c) Finalizimi i strukturës organizative

Rezultati: Gjatë mbledhjes së parë të Kuvendit të mbajtur më 17 dhjetor 2008, u votuan Kryetari, Nënkyetari dhe anëtarët e Bordit të STIKK.

d) Angazhimi i stafit permanent dhe funksionalizimi i zyrës

Rezultati: Gjatë periudhës janar-shkurt 2009, përfunduan procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të STIKK, ndërsa kontrata u nënshkrua më 23 shkurt 2009. Anëtari i dytë i stafit u punësua në qershor 2009. Zyrën, pajisjet dhe inventarin e ofroi Crimson Capital (me kompensim), dhe kjo gjë mundësoi fillimin e menjëhershëm të aktiviteteve të shoqatës. Dy (2) kompjuterë të tjerë dhe një printer u dhuruan nga USAID KPEP, ndërsa një kompjuter, një printer, një skener dhe një aparat digjital u dhuruan nga anëtarët e STIKK (Comtrade, Cactus, Elting,PBC). Ueb faqja e STIKK u disejnuar falë angazhimit vullnetar të kompanisë Rrota.

3.2. Aktivitetet sipas objektivave të përcaktuar në mbledhjen e Kuvendit, më 17 dhjetor 2009

a) Përpilimi i të dhënave dhe hulumtimi i tregut të TIK-ut në Kosovë dhe rajon

Rezultati: Baza e shënimeve fillestare mbi profilin e kompanive anëtare u krijua gjatë tremujorit të parë. Një studim i hollësishëm i tregut është realizuar nga KPEP në periudhën nëntor–dhjetor 2009. Ky studim duhet të ofrojë shënime mbi sektorin e TIK-ut, mbi nevojat e sektorit duke përfshirë këtu nevojat në lidhje me burimet njerëzore, si dhe kërkesat dhe pritjet që ka sektori ndaj shoqatës, STIKK. Informatat specifike nga ky hulumtim përfshijnë:

1. Madhësinë e tregut të TIK në Kosovë, segmentimin e tij, rritjen në fushat e caktuara si dhe parashikimin e zhvillimit të sektorit
2. Ofruesit kyç të TIK, të identifikuar në tregun e TIK dhe mundësitë e tyre
3. Nevojat e kompanive të TIK lidhur me burimet njerëzore dhe trajnimet
4. Problemet e identifikuar që pamundësojnë rritjen dhe zhvillimin e kompanive të TIK në Kosovë.

Rezultatet e hulumtimit do të jenë të inkorporuar në një bazë e shënimeve të krijuar nga kontraktori për këtë qëllim. Baza është bazuar në ueb dhe përmban informata mbi të gjithë anëtarët e STIKK. Ndërfaqja ka edhe pjesën për qasje nga publiku e që paraqet listën e kompanive nga sektori i TIK me Emrin e kompanisë; Selinë; Numrin e telefonit; numrin e fax-it dhe linkun në uebfaqen e kompanisë.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të prezantohen në mbledhjen e përgjithshme të Kuvendit, më 28 janar 2010, ndërsa çështjet e identifikuar në këtë hulumtim do të shërbejnë si bazë e përcaktimit të drejtimit të mëtejshëm të aktiviteteve të STIKK në të ardhmen (plani strategjik, plani vjetor i punës etj).

b) Të qenurit i azhurnuar dhe publikimi i broshurave elektronike në lidhje me trendet përkatëse të industrisë në Evropë dhe për mundësitë biznesore

Rezultati: Publikimi i broshurave elektronike është planifikuar por nuk është realizuar gjatë vitit 2009, për shkak të dilemës se çka do të duhej të jetë përmbajtja e broshurave (përveç aktiviteteve të shoqatës). Sipas raportit preliminar të hulumtimit të tregut, anëtarët janë të interesuar të kenë informata rreth ofertave biznesore (tenderëve) në vend dhe në rajon. Kjo broshurë elektronike planifikohet të fillojë në tremujorin e parë të vitit 2010.

c) Lobimi për anëtarët e shoqatës për adresimin e çështjeve siç janë tarifatat doganore për sektorin e TIK-ut.

Në kuadër të këtij aktiviteti, janë ndërmarrë disa hapa:

1. Janë realizuar takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së punës dhe Mirëqenies Sociale (Ministri Rashiq ka bërë edhe hapjen e panairit të punës për sektorin e TIK), Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit. Këto takime kanë pasë për qëllim njohjen e STIKK nga ana e Institucioneve Qeveritare.
2. Me financimin e Crimson Capital, është realizuar një studim mbi gjendjen e sistemit doganor dhe TVSH-së në vendet e rajonit. Ky studim është një pikënisje për lobim, i cili do të përforcohet me punën e Komisionit për legjislacion, që do të themelohet gjatë mbledhjes së Kuvendit të STIKK.

d) Integrimi i sektorit dhe krijimi i rasteve për anëtarët e shoqatës, e posaçërisht bizneset e vogla

Rezultati: Gjatë periudhës raportuese, drejtoresha ekzekutive e STIKK, ka vizituar shumicën e anëtarëve të shoqatës, me qëllim të identifikimit të nevojave dhe problemeve me të cilat ballafaqohet sektori i TIK. Në të njëjtën kohë, STIKK ka krijuar marrëdhënie shumë të mira me shoqatat tjera aktive të Kosovës, me të cilat mban takime të rregullta mujore (shoqata e përpunuesve të drurit, shoqata e organizatave mikrofinanciare, shoqata e arkitektëve,

shoqata kosovare për ndërtimin e rrugëve, shoqata e kontabilistëve dhe auditorëve të certifikuar, oda ekonomike amerikane, shoqata e turizmit, dhe shoqata e bankave.)

Aktiviteti i STIKK për krijimin e partneriteteve rajonale ka rezultuar me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me Shoqatën e Teknologjisë Informative të Shqipërisë (AITA) dhe Odën e Teknologjisë Informative të Maqedonisë (MASIT).

e) Për të shërbyer si portal për investuesit e huaj dhe për joshjen dhe ftuarjen e bizneseve potenciale të interesuara për investime në TIK-un e rajonit.

- 1. Takim me përfaqësuesit e NORFUND-it dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, të cilët janë të interesuar të përkrahin Qendrën e Inovacioneve të TIK (ICT Innovation Center)*
- 2. Takim përmbajtësor me JICA (Japan International Cooperation Agency) rreth involvimit të STIKK në aktivitetet që Qeveria Japoneze dëshiron ti financojë në Kosovë.*
- 3. Pjesëmarrje në përpilimin e strategjisë për investime të jashtme në kuadër të IPAK, ku sektori i TIK është identifikuar si sektor prioritar për tërheqjen e Investimeve Direkte të Jashtme (Foreign Direct Investment)*
- 4. Takime pune me Shoqatën e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit të Norvegjisë (IKT-Norge) rreth realizimit të tre projekteve të mundshme: Reciklimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike; vendosja e filtrave në uebfaqet që bëjnë abuzime të fëmijëve si dhe mundësia e organizimit të një takimi B2B me kompanitë Norvegjeze.*
- 5. Takime me përfaqësuesit e USAID, KPEP, UNDP, Swisscontact*
- 6. Takime të vazhdueshme me MASIT dhe AITA*

f) Implementimi i fushatave të marketingut për rritjen e imazhit pozitiv të industrisë së TIK-ut para sektorit publik dhe atij privat

- 1. Përgatitja e materialit promovues dhe prezantimi i STIKK-ut në panairin e ITTF më 24-26 mars 2009; Ky aktivitet ka rezultuar me rritjen e numrit të anëtarëve prej 41 në 61 anëtarë.*
- 2. Pjesëmarrja në Konferencën për broadband SCTE, më 12 mars 2009 dhe 1 tetor 2009; Pjesëmarrja në Panairin e turizmit, më 22 prill 2009; Pjesëmarrja në Panairin e drurit, më 6 maj 2009; Pjesëmarrja në Takimin B2B, më 12 maj 2009, organizuar nga AmCham Kosovë dhe AmCham Maqedoni dhe CEED; Pjesëmarrja në Konferencën e Microsoft Tech Update, më 13 maj 2009; Pjesëmarrja në Konferencën e KPEP mbi Fondin për Aktivitete Strategjike, më 13 maj 2009; Pjesëmarrja në Konferencën e MTPT, më 19 maj 2009*
- 3. Promovimi i parë publik në nivel të rajonit u realizua me pjesëmarrjen e STIKK në konferencat rajonale në Selanik: workshop " Training and Networking Session on ICT for Learning and e-Learning" dhe Sofje: Prezantim i USAID Competitiveness Project, dhe më vonë me prezantimin e STIKK në Konferencën regjionale - Ditët e MASIT, e mbajtur në Ohër, Maqedoni.*
- 4. Aktivitetet e pjesëmarrjes në panairot e ndryshme lokale dhe rajonale, konferenca dhe workshop-e, mundësuan zhvillimin e kontakteve të reja si dhe prezencën e STIKK në agjendat e donatorëve dhe palëve të tjera me interes.*

g) Zhvillimi i bazës të të dhënave për ekspertët e TIK-ut në fusha të ndryshme në Kosovë, siç janë të gjithë inxhinierët CISCO, Microsoft etj.

Kjo bazë e të dhënave do të zhvillohet krahas bazës së të dhënave për kompanitë e TIK.

h) Ofrimin dhe rritjen e mundësive për trajnim në fushat e nevojshme

- 1. Punëtorja (Workshop-i) për E-marketing u mbajt më 11 shtator 2009. Aty morën pjesë 26 përfitues prej të cilëve 23 përfaqësues të kompanive të TIK dhe 3 përfaqësues të*

shoqatave tjera biznesore. Trajnimin e mbajti eksperti ndërkombëtar në këtë fushë, Z. Kevin O'Loughlin, i asistuar nga kolegu i tij vendor, Z. Ardall Celina.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte ilustrimi i përfitimeve nga marketingu online si dhe promovimi i mjeteve të marketingut që i ofron interneti. Donator ishte programi KPEP i USAID-it, ndërsa kompanitë pjesëmarrëse paguan një shumë simbolike prej 10 eurosh në emër të participimit.

2. Punëtorja (Workshop-i) mbi të Drejtat Pronësore Intelektuale - u mbajt më 22-24 shtator 2009, në koordinim me Programin e Zhvillimit të Ligjeve Komerciale-CLPD të USAID-it. Morrën pjesë 14 përfaqësues të kompanive që mirren me zhvillim softuerik, puna e të cilëve ndikohet drejtpërdrejtë nga e Drejta Pronësore Intelektuale.
3. Punëtorja (Workshop-i) E-marketing për sektorin e turizmit – ishte përsëritje e workshop-it të parë por tani i disenjuar posaçërisht për sektorin e turizmit. Në workshopin e organizuar më 4 dhjetor, morën pjesë 25 kompani, anëtare të shoqatës së turizmit, dhe 3 kompani të TIK. Qëllimi i këtij workshop-i ishte që kompanitë e turizmit të njihen me instrumentet e marketingut si dhe të krijohen lidhjet biznesore në mes të këtyre dy sektoreve. Si edhe workshop-i i parë, projekti u mbështet nga KPEP/ USAID.
4. Panairi i punës për TIK - u organizua më 16 dhjetor 2009, me pjesëmarrjen e 8 kompanive të TIK që i publikuan gjithsej 26 vende të lira pune përmes dy portaleve online. Interesimi i punëkërkuësve ishte i madh (960 aplikantë), ndërsa në ditën e panairit janë realizuar 86 intervista. 28 kandidatë janë thirrur për intervista të dyta, ndërsa numri aktual i të punësuarve do të dihet në janar. Në kuadër të këtij projekti është organizuar edhe një seminar gjysëmditor për Burimet Njerëzore (HR) të kompanive të TIK, si dhe është bërë trajnimi online i punëkërkuësve. Projekti u mbështet nga programi KPEP i USAID-it ndërsa kompanitë pjesëmarrëse kanë paguar stendën në panair.

i) Për të punuar në përmirësimin e planprogrameve mësimore në institucione

STIKK mori pjesë në grupet punuese dhe në Këshillin Mbikëqyrës për hartimin e Strategjisë së mësimin elektronik, në kuadër të MASHT, organizuar nga Swisscontact.

Në përgaditje e sipër është marrëveshja e Bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës-fakultetin Teknik, lidhur me mundësitë e bashkëpunimit në mes sektorit privat dhe institucioneve arsimore.

j) Për të ndihmuar në krijimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të shoqatës dhe mundësive biznesore jashtë Kosovës, përmes rrjetëzimit dhe ngjarjeve biznesore. Përmirësimi i mundësive për hulumtim dhe zhvillim (R&D) në sektorin e TIK-ut.

Pas pjesëmarrjes në ditët e MASIT-it dhe në Bordin e SEE ICT FORUM dhe pas krijimit të kontakteve me shoqatat tjera të rajonit, STIKK është ftuar të merr pjesë në një projekt rajonal për hulumtim dhe zhvillim në sektorin e TIK.

Aktivitetet e planifikuara nga viti i kaluar dhe ato në vijim

1. Funkcionalizimi i komisionit për ECDL dhe i komisioneve të tjera
2. IT Mark training,
3. Takimet B2B me sektorin e TIK-në Shqipëri
4. CRM workshop,
5. Cyber Security: Trajnimi dhe certifikimi në ISO 27001, dhe në Cisco security)

4. Të hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2009, të hyrat e STIKK ishin nga 4 burime të mjeteve: GTZ, Qeveria Norvegjeze, KPEP dhe Anëtarët e STIKK (participimi në trajnime dhe aktivitete tjera). Detajet e të hyrave janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Të hyrat për periudhën janar-dhjetor 2009					
Kategoria	Crimson Capital	KPEP	GTZ	Te tjerë	Gjithsej
Të hyrat/Donacionet					
Donacionet	26,936.00	11,408.31	2,400.00	930.00	41,674.31
Në mall (qiraja dhe komunaliet)	4,213.00	-	-	-	4,213.00
Gjithsej të hyra/donacione	31,149.00	11,408.31	2,400.00	930.00	45,887.31

Shpenzimet

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet e STIKK arritën shumën prej 38,466.00 ose 83.83% të shumës së përgjithshme. Kësaj shume do ti shtohen edhe shpenzimet e mjeteve dhe pajisjeve, të cilat do të faturohen në janar të vitit 2010 nga Crimson Capital. Pasqyra e shpenzimeve në detaje është e prezantuar në shtojcën 1.

	Crimson Capital	KPEP	GTZ	Others	Total
Të hyrat	31,149.00	11,408.31	2,400.00	930.00	45,887.31
Shpenzimet					
Të ardhurat personale	18,675.15	-	-		18675.15
Mjete dhe pajisje					
Shpenzime operative	8,145.62	9,723.08	-	0	17868.7
Shpenzimet e transportit	1,179.15	743.00	-	0	1922.15
Gjithsej shpenzime	27,999.92	10,466.08	-	-	38,466.00
Gjendja	3,149.08	942.23	2,400.00	930.00	7,421.31

5. Përmbyllje

Përkundër vonesave fillestare në implementimin e disa aktiviteteve të parapara, STIKK ka vazhduar të angazhohet në implementimin sa më të suksesshëm të objektivave të përcaktuara nga ana e Kuvendit të anëtarëve. Pasi që në periudhën raportuese janë zhvilluar aktivitete që ndihmojnë në njohjen e STIKK si një pikë fokale e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit, në periudhën vijuese rëndësi e posaçme do ti jepet çështjes së avokimit dhe lobimit në Qeveri lidhur me legjislacionin aktual jo të favorshëm për zhvillimin e biznesit të mirëfilltë.

Në vitin 2010 objektivat e STIKK do të përqëndrohen në 5 fusha kryesore:

1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK
2. Rritja e imazhit pozitiv të industrisë së TIK-ut para sektorit publik dhe atij privat përmes implementimit të fushatave të marketingut
3. Ndihma në krijimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të shoqatës dhe mundësive biznesore jashtë Kosovës, përmes rrjetëzimit, ngjarjeve biznesore dhe integritimit në iniciativat rajonale
4. Zhvillimi i sistemit të edukimit dhe të shkathtësive në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK (*Workforce Development*)
5. Sigurimi i qëndrueshmërisë së shoqatës

Plani detaj i punës për vitin 2010 është i përshkruar në shtojcën 2.

**Prishtinë,
Janar, 2010**

SHTOJCA 1

	Crimson Capital	KPEP	GTZ	Others	Total
Income	31,149.00	11,408.31	2,400.00	930.00	45,887.31
Expenses					
Labor (including benefits/taxes)					
Executive Director	12,927.44	-	-	-	12,927.44
Other Staff	5,747.71	-	-	-	5,747.71
Total Labor	18,675.15	-	-	-	18,675.15
Equipment & Furniture					
Furniture	-	-	-	-	-
Equipment	-	-	-	-	-
Total Equipment & Furniture	-	-	-	-	-
Operating Expenses					
Office Rent	2,750.00	-	-	-	2,750.00
Utilities & Security	1,463.00	-	-	-	1,463.00
Phone & Fax	161.20	207.39	-	-	368.59
Internet	-	-	-	-	-
Marketing & Advertising	527.94	3,236.30	-	-	3,764.24
Bank Services	64.00	-	-	-	64.00
Legal Services	-	-	-	-	-
Accounting Services	1,600.00	-	-	-	1,600.00
Promotional activities	-	1,132.00	-	-	1,132.00
Consultants fee	-	4,454.70	-	-	4,454.70
Other	1,579.48	692.69	-	-	2,272.17
Total Operating Expenses	8,145.62	9,723.08	-	-	17,868.70
Travel					
Local & Regional Travel	1,179.15	743.00	-	-	1,922.15
Total Travel	1,179.15	743.00	-	-	1,922.15
Total Expenses	27,999.92	10,466.08	-	-	38,466.00
Net Surplus	3,149.08	942.23	2,400.00	930.00	7,421.31
Cash on bank on 31.12.2009					9,236.83
Cash on hand on 31.12.2009					567.35
Total Cash					9,804.18
Tax Payable on 31.12.2009					207.57
Pension Payable on 31.12.2009					265.30
Consultants payable					1,910.00
Total payable					2382.87
Cash - Payable					7,421.31